



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 06.06.2023

Nr: 175

Ora: 18:00

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 76, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA  
KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 06.06.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe z. Ivi Kaso

**PALË E INTERESUAR:** Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji dhe z. Maringlen Legisi.

**OBJEKT:**

1. Kundërshtim i vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;
2. Rinumërim dhe rivlerësimin e votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore si dhe Miratimi i Tabelës së re Përmbledhëse për zonën zgjedhore Belsh duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave;
3. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore, bashkia Belsh;
4. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkia Belsh, duke mospërfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë;
5. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 123/1 dhe pika 3 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Zona zgjedhore bashkia Belsh ka një zonë të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 45. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ nr. 45 nuk ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, duke ia deleguar këtë kompetencë KQZ-së, për të marrë vendim mbi Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve.

2. Më datë 18.05.2021, me vendimin nr. 533, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë, në zonën zgjedhore bashkia Belsh për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, duke shpallur fitues për kryetar të bashkisë Belsh z. Arif Faik Tafani, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe z. Ivi Kaso, duke kërkuar kundërshtimin e vendimit të Komisionerit, si më lart cituar, si dhe miratimin e Tabelës së re Përmbledhëse, pas rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore, bashkia Belsh. Në kërkesën e tyre ankimore shprehin se duhet hequr rezultatin zgjedhor i qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, si dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në këtë QV të posaçme.
4. Kërkesa ankimore nr. 76, e depozituar në KQZ më datë 22.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim, me relator z. Ledio Braho. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit më datë 30.05.2023, ora 12:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, përfaqësuesit e palës ankimuese, z. Franci Nuri dhe z. Ivi Kaso, kandidati i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Bedri Qypi, si dhe përfaqësuesit e palës së interesuar, z. Eridian Salianji dhe z. Maringlen Legisi.
5. Subjekti ankues, në kërkesën e tij ankimore ka pretenduar një grup shkeljesh që kanë lidhje me numërimin, vlerësimin dhe tabulimin e rezultatit të zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Belsh, si vijojnë:
  - Nga të dhënat në Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit rezulton se numri i votave të pavlefshme është 229, ndërkohë që diferenca me kandidatin fitues është vetëm 40 vota.
  - Sipas vëzhguesve të ankuesit nuk përputhet deklarimi i vlerësimit të votave me tabelat e rezultatit që janë hartuar nga grupet e numërimit të votave për QV-të: 2551/00, 2551/01, 2552/00, 2552/01, 2553/00, 2553/01, 2554/00, 2555/00, 2556/00, 2557/00, 2558/00, 2558/01, 2559/00, 2560/00, 2561/00, 2561/01, 2562/00, 2563/00, 2564/00, 2565/00, 2566/00, 2585/00, 2586/00.

- Në QV-të nr. 2564 Fierzë dhe nr. 2566 Çerragë ka pasur fletë votimi me mungesë të vulës së Kryetarit ose Sekretarit të cilët janë vlerësuar nga GNV-të si të pavlefshme, ku shumica e tyre kanë qenë në favor të kandidatit për kryetar z. Bedri Qypi.
  - Ka pasur fletë votimi të votuara me shkronja ose numra, të cilat janë vlerësuar nga GNV-të si të vlefshme, gjë që bie ndesh ne ruajtjen e fshehtësisë të votës, sepse e bën të identifikueshme votën. Gjatë numërimit janë konsideruar vota të vlefshme votat për kandidatin socialist, ku përbri emrit të tij nuk ishte shenja "+" ose "x", por gërma "A", gërma të tjera apo shifra. Këto shenja, sipas ankimesit, janë të ndaluara dhe lejojnë gjurmimin apo identifikimin e votës, ndaj automatikisht ato duhet të ishin konsideruar si "fletë votimi të pavlefshme".
  - Dy fletë votimi për kryetar në QV 2551/00, për shkak të një gabim njerëzor, janë futur poshte pajisjes së kamerës dhe janë gjetur më vonë pasi është mbyllur kutia. Dy fletët e votimit janë të vlefshme dhe i përkasin kandidatit për kryetar z. Bedri Qypi. Ato nuk janë pasqyruar në rezultatin përfundimtar për kandidat.
  - Fletë votimi të cilat janë njollosur me bojën e tamponit të KQV-së gjatë votimit nga GN-të janë vlerësuar si të pavlefshme.
5. Lidhur me kërkesën për deklarin e pavlefshëm të zgjedhjeve në QV-në nr. 2565/01, ankuesi parashtron:
- QV 2565/01 IEVP Burgu Kosovë ka pasur mungesë të kamerës dhe pajisjes PEI gjatë procesit të votimit gjë që tregon parregullsinë e votimit të burgosurve dhe mosigurimin e ruajtjes së fshehtësisë së votimit. Rezultati afërsisht 100% në favor të kandidatit të PS-së bën të dyshimtë se votimi në këtë QV ka qenë i diktuar duke pasur parasysh mungesën e kamerës dhe pajisjes PEI.
  - KZAZ nr. 45 bazuar në kërkesën e KQZ-së mbi ngritjen e KQV-së 2565/01 dhe duke u mbështur në verifikimin e të dënuarve në këtë institucion konstatoi se nuk ka banorë të Bashkisë Belsh, me vendimin nr. 3 datë. 25.03.2023 i ka propozuar KQZ-së që QV-ja 2565/01 të mos ngrihet

në këtë institucion. KQZ ka marrë vendim për ngritjen e kësaj QV-je, 2 ditë para zgjedhjeve, në mungesë të plotë transparence, si dhe pa garantuar aspak kushtet më minimale të organizimit të një procesi zgjedhor të rregull dhe të drejtë (votim pa kamera, pa pajisje PEI).

- Në qendrën e votimit të IEVP-së Burgu Kosovë është prodhuar një rezultat i padrejtë dhe i paligjshëm. Nga 29 zgjedhësit që kanë votuar në atë QV, disa prej tyre nuk duhet të votojnë, pasi janë në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Dekriminalizimin, si dhe nuk kanë vendbanimin ligjor aty.

6. Përveç sa më sipër, ankuesi ngriti pretendime të tjera për shkelje dhe parregullsi, por nuk lidhi kërkime me to, si p.sh.:

- QV-ja nr. 2565/00 Kosovë, pajisja PEI nuk ka funksionuar për 3 orë dhe rrjedhimisht votimi i qytetarëve nuk ka vazhduar, gjë që ka penguar pjesëmarrjen në votime. Qytetarë të cilët kanë shkuar gjatë kohës që pajisja PEI nuk funksiononte nuk janë rikthyer më për të votuar.
- QV-ja nr. 2556/00 ka pretendime se votimi nuk është bërë i rregullt dhe kanë votuar persona më shumë se 1 në dhomat e votimit.
- Në QV-në 2553/00 një votues ka votuar hapur në favor të kandidatit për kryetar z. Bedri Qypi, kryetari i KQV-së ia ka marrë fletën e votimit dhe ka vendosur shenjë dalluese mbi të dhe më pas e ka futur në kutinë e votimit, duke e nxjerrë të pavlefshme fletën e votimit dhe nuk i ka dhënë fletë të dytë qytetarit sipas ligjit.
- Në GNV-të, nga ana e subjektit PS janë propozuar persona, të cilët janë në marrëdhënie pune me kandidatin e PS-së për kryetar, z. Arif Tafani.

7. Gjatë shqyrtimit të çështjes, ankuesi paraqiti këto kërkesa:

- KAS-i të evidentojë qartë se cili nga të dënuarit e listës së zgjedhësve të IEVP Belsh që ka marrë pjesë në procesin zgjedhor, ka patur të drejtë të votonte sipas lejimeve dhe ndalimeve të ligjit për dekriminalizimin;

- të merreshin si prova regjistrimet e kamerave vëzhguese për të gjitha QV-të e ZAZ nr. 45;
- të administroheshin si prova Libri i Protokollit të Mbledhjeve, procesverbalet e konstatimit, tabelat e rezultateve të grupeve të numërimit për çdo QV.

Kërkesa për informacion lidhur me të burgosurit iu adresua Drejtorisë të Përgjithshme e Burgjeve me saktësimin dhe plotësimin nga ana e KAS-it për 24 zgjedhësit e pajisur me vendim gjyqësor për të votuar në IEVP Belsh, duke kërkuar në mënyrë specifike datën kur këta të burgosur janë dërguar për të vuajtur dënimin, nëse masa e dënimit është më e gjatë se tre muaj, si dhe nëse janë në kushtet e ndalimit për të votuar këta persona, sipas Ligjit nr. 138/2015. Kërkesat e tjera u plotësuan nga administrata e KQZ-së jashte seancës. KAS-i i dha ankuesit kohën e nevojshme që të këqyrte këto prova dhe të qëmtonte prej tyre faktet që i shërbejnë kërimit të tij në KAS.

#### 8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 80, datë 23.05.2023;
- Vendimin nr. 533, datë 18.05.2023 të Komsisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;
- Librin e Protokollit në KZAZ nr. 45;
- Vendimi nr. 501, datë 12.05.2023 “Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 2565/01, në KZAZ nr. 45, bashkia Belsh, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”;
- Shkresa dërgim dokumentacioni, dërguar nga DPB me nr. 4208 prot., datë 31.03.2023 drejtuar Gjendjes Civile, Belsh;
- Kërkesa e datës 18.05.2023 e koalicionit "Bashkë Fitojmë", drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, protokolluar në KQZ me nr. 5248, datë 18.05.2023.
- Kthim përgjigje nga KQZ nr. 5248/1 prot., datë 21.05.2023, drejtuar z. Franci Nuri;

- Shkresa nr. 5665 prot., datë 31.05.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve
- Shkresa kthim përgjigje nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, nr. 5662/2 prot., datë 02.06.2023
- Vendimi nr. 3, datë 25.03.2023 mbi ngritjen e KQV 2565/1 i KZAZ-së nr. 45, Belsh
- Shkresë kërkesë nga KZAZ nr. 45, Belsh dhe kryetari i bashkisë z. Blerim Tafani, për ngritjen e KQV-së posaçme, nr 5033 prot., datë 12.05.2023 drejtuar KQZ-së;
- Shkresë-kërkesë nga kryetari i bashkisë Belsh, për regjistrim votuesish nr. 5042 prot., datë 12.05.2023, drejtuar KQZ-së (bashkangjitur 24 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan);
- Provat e depozituara në seancë themeli, më datë 05.06.2023, nga subjekti ankues (materiale foto mbi fletët e votimit të konstatuara nga pamjet filmike);
- USB e depozituar nga subjekti ankues me provat përkatëse;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

**KAS-i konstaton:**

1. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi.

2. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë *ipso lege* kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave *“për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”*.
3. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”*. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës *“b”* të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve *“të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”*.
4. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se *“KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës *“c”* të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”*. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.
5. Kodi Zgjedhor njeh rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave përgjatë procedurës ankimuese, por Kodi e pranon rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave vetëm për vota të caktuara dhe vetëm në rrethana tejet specifike. Vota të caktuara janë, sipas pikës 3 të nenit 138 të Kodit



Zgjedhor, “votat e identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi”. Kjo do të thotë se numërimi dhe/ose vlerësimi i votave duhet të jenë shoqëruar me kontestime apo me konstatimin e pasaktësive, për to duhet të jenë bërë shënimet përkatëse në fletët e kontestuara, në tabelën e rezultateve të kontestuar apo në librin e protokollit të KZAZ-së, me qëllim që ato të mund t’i nënshtrohen procedurës së rinumërimit dhe/ose rivlerësimit.

6. Neni 116 i Kodit Zgjedhor përcakton se kur shifra e totalit të fletëve të votimit të gjetura në kuti nuk përputhet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, atëherë KZAZ-ja e pasqyron pasaktësinë në **Procesverbalin e Konstatimit**. Neni 118 përcakton procedurën e administrimit të fletëve të kontestuara, të cilat, pas kontestimit, rivlerësohen nga GNV-ja dhe, nëse kontestimi mbahet në këmbë, vlerësohen nga KZAZ-ja. Rezultati i shpallur shënohet në **librin e protokollit të KZAZ-së** dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave. Për secilën fletë të kontestuar, **në pjesën e prapme** të saj numëruesi i parë i Grupit të Numërimit **shënon qartë arsyet e kontestimit**. Për votat e kontestuara mbahet një procesverbal i veçantë, në të cilin pasqyrohet numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, **fletët e votimit të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA**. Neni 119 përcakton se kur ka kontestime për **tabelën e rezultateve për qendrën votimit** që harton GNV-ja, kontestimet e anëtarëve të GNV-së shënohen në tabelë, kurse kontestimet e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore shënohen në **librin e protokollit të KZAZ-së**.
7. Pika 3 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor përcakton se secili anëtar i KAS-it ka të drejtë të kërkojë dhe KAS-i është i detyruar të kryejë rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara, por kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare apo voluntariste. Si kur rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e kërkojnë anëtarët e veçantë, ashtu dhe kur e kërkojnë palët, përpara se të vendoset rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave të caktuara duhet të merret dhe administrohet prova përkatëse e kontestimit, sepse sipas nenit 136 të Kodit Zgjedhor **pa kontestim nuk ka rinumërim dhe/ose rivlerësim**. Nëse kërkohet rinumërimi i totalit të votave të hedhura në kuti,

për shkak se janë konstatuar pasaktësi, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht **Procesverbali i Konstatimit**. Nëse kërkohet rivlerësimi i votave të kontestuara, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht **libri i protokollit të KZAZ-së** me shënimet për rezultatin e shpallur për votat e kontestuara. Nëse kërkohet rinumërim dhe/ose rivlerësim tërësor ose pjesor i votave të qendrës së votimit, atëherë duhet të merret dhe administrohet paraprakisht **tabela e rezultateve për qendrën votimit** me shënimin kundërshtues të anëtarit të GNV-së dhe **libri i protokollit i KZAZ-së** me shënimin kundërshtues të vëzhguesit të subjektit zgjedhor.

8. Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk bëhet pa procedurë paraprake kontestimi. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim thjesht dhe vetëm për shkakun se diferenca e votave midis dy kandidatëve konkurues është më e vogël se numri i votave të pavlefshme. Rinumërimi *ipso lege* ka qenë njohur nga Kodi Zgjedhor në formatin e tij fillestar të vitit 2000, por ligjvënësi hoqi dorë shpejt nga ky modalitet. Kërkesa për rinumërim për diferencë të ulët votash sot është pa bazë ligjore. Po kështu, nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim për shkak të pretendimit se rezultati i votimit duket “i panatyrshëm”, “i çuditshëm”, “i paarsyeshëm”, “i pabesueshëm”, apo bazuar në ‘dysime të arsyeshme’ se mund të ketë pasur gabime, pasaktësi, parregullsi apo devijime në tabulim. Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk mund të bëhet thjesht dhe vetëm për shkak se vëzhguesit e subjektit kanë tabuluar rezultat të ndryshëm nga rezultati i tabuluar nga GNV-të, apo për shkakun se ata nuk ka në qenë të pranishëm në procedurën e numërimit fillestar. **Pretendimet e vëzhguesve të subjektit nuk formojnë provë dhe prania e tyre në numërim nuk është kusht për vlefshmërinë e numërimit.** Vëzhguesit janë pjesë e subjektit dhe pretendimet e tyre, ashtu si çdo pretendim tjetër i subjektit duhet të provohen nga ankuesi, përpara se çështja të marrë zgjidhje ligjore.
9. Sipas nenit 136 të Kodit Zgjedhor, marrja e provës ex officio bëhet në dy raste, kur palët “*kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyt përse nuk ka qenë e mundur sigurimi i tyre*” (shkronja “c” e pikës 1 të nenit 136), si dhe kur vetë KAS-i “*çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit*” (pika 2 e nenit 136). Qëllimi i hetimit administrativ është zbulimi dhe vërtetimi i plotë i rrethanave që ndihmojnë vendimmarrjen në çështjen objekt shqyrtimi. Kjo është arsyeja pse Kodi Zgjedhor kufizon diskrecionin e trupës së KAS-it në marrjen dhe shqyrtimin

e provave, kur përcakton se KAS-i “mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara” dhe se ky refuzim duhet të jepet i arsyetuar në vendimin përfundimtar (pika 4 e nenit 136). Megjithatë, kuadri normativ i nenit 136 të Kodit Zgjedhor nuk mund të lexohet në kundërshtim me parimin e “barrës së provës”. Asnjë nga dispozitat e këtij neni, që formojnë detyrim për KAS-in për marrjen dhe shqyrtimin e provave, nuk mund të lexohet si mjet ligjor për të çliruar palën nga detyrimi për t’i siguruar vetë dhe paraprakisht provat që mbështesin pretendimet e ngritura në kërkesën ankimore.

10. Kodi i ka njohur dy anëtarëve të KAS-it privilegjin që të sigurojnë pa debat apo votim marrjen e provës (privilegji i pakicës), kur prova kërkohet nga pala dhe disponohet nga KQZ-ja. Privilegji i pakicës është mjet ligjor në duart e anëtarëve në pakicë, me qëllim që ata të anashkalojnë “diktatin e shumicës”. Por privilegji i pakicës nuk është ushtrim arbitrar apo voluntarist i të drejtës. Ai nuk mund të ushtrohet në zëvendësim të detyrimit të palës për të siguruar vetë dhe paraprakisht provat që mbështesin pretendimet e saj, nuk mund të ushtrohet për të arritur qëllime të tjera nga ato të hetimit administrativ konkret, nuk mund të ushtrohet i palidhur me faktet e pretenduara. Privilegji i pakicës mund të ushtrohet vetëm në kushte ligjshmërie. Privilegji i pakicës nuk i nënshtrohet debatit apo votimit, përveçse kur ai ushtrohet pa administruar më parë kërkesën për marrjen e provës, të paraqitur nga ndonjera nga palët në proces, ose kur prova që pakica kërkon të marrë dhe administrojë nuk disponohet nga KQZ-ja.
11. Kërkesa e ankuesit për rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit të pavlefshme dhe e votave të kandidatëve për kryetar bashkie në zonën zgjedhore bashkia Belsh është kërkesë e paligjshme në gjykimin e shumicës së anëtarëve të KAS-it. Ankuesi kërkoi rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjitha votave të hedhura, kur ligji lejon rinumërimin dhe rivlerësimin e vetëm votave të caktuara, vetëm të votave të identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të Kodit, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe të votave të tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të Kodit. Shqyrtimi në seancë provoi se në këtë zonë zgjedhore nuk ka pasur kontestim të vlerësimit të votave dhe as kontestim të tabulimit të tyre gjatë procesit të numërimit të kryer

nga GNV-të. Rinumërim dhe rivlerësim apriori, pa shkak ligjor, të votave nuk mund të ketë. Kjo është arsyeja që shumica rrëzoi kërkesën e ankuesit për kryerjen e rinumërimit dhe rivlerësimin tërësor të votave. Shumica gjykon, se për të njëjtin shkak është i pajustificueshëm edhe ushtrimi i privilegjit të pakicës nga dy anëtarët e trupës që mbështetën kërkesën e paligjshme. Por, sa kohë që ushtrimi i privilegjit të pakicës nuk mund të hidhet në votim dhe nuk mund të pengohet, KAS-i është i detyruar t'a pranojë dhe t'i hapë rrugë marrjes së provës, me këtë konstatim për paligjshmëri veprimi.

12. Pretendimi i ankuesit, i parashtruar në tekstin e kërkesës ankimore nr. 76, në kohën kur ankuesit nuk i ishin vënë në dispozicion pamjet video nga numërimi dhe vlerësimi i votave, ishte se janë konsumuar shkelje të rënda të ligjit zgjedhor në procesin e numërimit ku pothuaj për çdo QV të numëruar rezultati i dalë dhe i pasqyruar në tabelat e numërimit nuk pasqyron rezultatin e vërtetë". KAS-i i dha mundësinë dhe kohën ankuesit që t'i këqyrte pamjet video dhe të sillte provat e nevojshme për të mbështetur këtë pretendim. Ankuesi nuk mundi që ta provonte pretendimin e parashtruar në kërkesën ankimore. Provat video që depozitoi ankuesi i referohen tabulimit të dy votave më tepër për kandidatin e PS në QV nr. 2562, dhe më pak se 10 rasteve, ku kandidati bënte vlerësim të votave ndryshe nga GNV-ja. Pavarësisht nga kjo, ankuesi paraqiti kërkesën për rinumërim dhe rivlerësim të të gjitha votave të vlefshme e të pavlefshme, pa asnjë bazë ligjore. Kërkesa u mbështet nga dy anëtarë të KAS-it.
13. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave që u krye nga administrata e KQZ-së me pjesëmarrjen e vëzhguesve nga palët dhe nën mbikëqyrjen e KAS-it nuk zbuloi shkelje që mund të konsideroheshin cënim i rregullave në zbatimin e procedurës. KAS-i konstatoi nga këqyrja e votave të kontestuara në procesin e rinumërimit dhe rivlerësimin, se vlerësimi i votave ishte kryer nga grupet e numërimit sipas standartit dhe në përputhje me udhëzuesin e punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", miratuar me vendimin nr. 24, datë 05.05.2023 të Komisionit Rregullator. KAS-i e ndryshoi vlerësimin e bërë nga GNV-të vetëm për një numër të parëndësishëm votash, bazuar në leximin e ndryshëm dhe respektimin më adekuat të vullnetit të votuesve. Në përfundim të procedurës, diferenca e votave midis kandidatit fitues dhe

kandidatit të ankuesit u rrit nga 40 në 49 vota. Tabela me rezultatin e rinumërimit dhe rivlerësimit i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave ezauroi nevojën për të marrë në shqyrtim dhe për të debatuar për grupin e pretendimeve të ankuesit dhe provat korresponduese që kishin lidhje me rezultatin.
15. Ankuesi kërkoi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në QV nr. 2565/01. Pavlefshmëria e zgjedhjeve është mjet ligjor në duart e subjekteve ankuese, i cili mundëson anulimin e votimit/rezultatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:
- a) shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;
  - b) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose
  - c) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.
15. KAS-i e ka trajtuar gjerësisht analizën ligjore për kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në vendimarrjen e tij për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 (p.sh. vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Në këto vendime, KAS-i ka arsyetuar, se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. **Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit**

**në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.** Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu shitblerja e votës, që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh, nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike.

16. KAS-i ka vlerësuar se masa kritike është kriteri kyç në gjykimin e kërkesave për pavlefshmëri të zgjedhjeve. Masa kritike ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një demokraci në tjetrën, sepse masa kritike varet tërësisht nga shkalla e zhvillimit demokratik. Në çdo demokraci qëllimi është zhvillimi i zgjedhjeve dhe legjitimitimi i pushtetit nga populli. Masa kritike është instrumenti që mbron zgjedhjet dhe demokracinë nga deligjitimitimi.
17. KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjete ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik, që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimit të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.
18. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur

pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.

19. KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet përcaktimit të kriterëve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”. Shkeljet që çënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre, sikurse aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën... (duhet të jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.
20. KAS-i, në shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmëri është udhëhequr nga jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013. Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final”. **Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë çënuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por**

duhet të provosh se këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi se shkelja përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve” duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata.

21. Ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në QV nr. 2556/01 të IEVP Belsh (burgu i Kosovës) me pretendimin se aty kishin votuar persona pa të drejtë vote në këtë bashki. Ankuesi demonstroi me prova se kishte bërë përpjekjet e nevojshme për të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të dhënat e plota për historikun e vuajtjes së dënimit për të dënuarit e strehuar në IEVP Belsh. Këto të dhëna i duheshin për të parë *“nëse janë respektuar ose jo kriteret ligjore mbi bazën e të cilave zgjedhësit rezultojnë që në atë ditë të kishin vendbanimin në IEVP Belsh”*, si dhe për të *“evidentuar qartë se cili nga të dënuarit e listës së zgjedhësve të IEVP Belsh (që) ka marrë pjesë në procesin zgjedhor ka patur të drejtën të votonte sipas lejimeve dhe ndalimeve të ligjit të dekriminalizimit”*. Të dhënat për historikun e vuajtjes së dënimit janë në themel të kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve në QV nr. 2565/01. Administrimi i këtyre të dhënave nga KAS-i është i domosdoshëm për të gjykuar dhe vendosur për kërkesën për pavlefshmëri.
22. Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për historikun e vuajtjes së dënimit të të burgosurve votues të kësaj QV-je çojnë në konstatimin vijues:
- (a) Në QV nr. 2565/01 IEVP Belsh nuk ka pasur listë zgjedhësish. Qendra e votimit është ngritur për shkak se 24 zgjedhës kanë siguruar të drejtën e votimit me vendim gjyqësor, sipas nenit 57 të Kodit Zgjedhor. Në qendrën e votimit kanë votuar 29 zgjedhës, 7 komisionerët me të drejtën që u jep pika 1 e nenit 58 të Kodit Zgjedhor, dhe 22 zgjedhës kanë votuar me vendime gjyqësore. Votimi i komisionerëve në QV ku ushtrojnë detyrën dhe votimi me vendim gjyqësor janë në vetvete veprime të ligjshme.
- (b) Ngritja e QV nr. 2556/01 është autorizuar nga Komisioneri me vendimin nr. 501, datë 12.05.2023, pas marrjes së informacionit se në këtë institucion kishte 24 të burgosur që



kishin siguruar të drejtën për të votuar me vendime gjykatë dhe është zbatuar nga KZAZ-ja nr. 45, bashkia Belsh. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim dhe subjektet zgjedhore që kanë pasur të drejtën për propozimin e anëtarëve të KQV-së kanë bashkëpunuar për ngritjen dhe funksionimin e KQV-së përkatëse. Vendimi është i ligjshëm, ndërkohë që mosngritja e QV-së, në kushtet kur kishte zgjedhës të pajisur me vendime gjyqësore për të votuar do të përbënte përjashtim të zgjedhësve nga e drejta për të votuar, e cila është shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor.

- (c) Neni 18 i ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, i ndryshuar, përcakton se *“për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës”*. Nga të dhënat e servitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr.6946/1 prot., datë 01.06.2023 për listën prej 24 personash që kanë fituar të drejtën e votimit me vendim gjyqësor në këtë institucion rezulton se, për 22 prej tyre (përveç nr. 1 dhe nr. 9 të listës), drejtoria e IEVP Belsh duhet të kishte aplikuar për regjistrimin e tyre në gjendjen civile bashkia Belsh menjëherë pas pranimit të tyre në institucon. Nëse drejtoria e IEVP Belsh do kishte zbatuar detyrimin që buron nga neni 18 i ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 *“Për gjendjen Civile”*, i ndryshuar dhe nga pika 4 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12.2009, atëherë këta 22 shtetas do figuronin në listën e zgjedhësve të QV nr. 2565/01, sepse do duhet të ishin regjistruar brenda 48 orëve nga data e regjistrimit në institucion pranë zyrës së gjendjes civile të bashkisë Belsh (Pika 4 e VKM nr. 1243, datë 11.12.2009: *“Për shtetasit ... që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit ... dhe, kur qëndrimi në këto institucione zgjat më shumë se tre muaj, institucioni përgjegjës duhet të paraqesë, brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të tyre në institucion, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, listën emërore të tyre”*).
- (d) Personi me nr. 9 në listën bashkëlidhur shkresës nr.6946/1 prot., datë 01.06.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton nga informacioni se është planifikuar për një kohë qëndrimi jo më të gjatë se 3 muaj në institucion. Për këtë shkak, ai nuk mund të regjistrohet si banor i bashkisë Belsh. Për më tepër, transferimi dhe pranimi i tij në institucion

është bërë 5 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve. Pika 2 e nenit 57 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“në rast se zgjedhësi ndryshon vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon dhe zgjedhësi voton në qendrën e votimit ku ka emrin në listën e miratuar. Në rast se zgjedhësi paraqet kërkesë në gjykatë në kushtet e kësaj pike, kërkesa rrëzohet”*. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila ka lejuar votimin e personit, me vendimin nr. 22, datë 10.05.2023 ka konstatuar se zgjedhësi figuronte i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV nr. 1489/01 Durrës. Pavarësisht nga arrestimit, ky zgjedhës ndodhet në kushtet kur nuk i ndryshon vendbanimi, sepse dënimi i tij ka qenë 3 muaj. Gjykata nuk e ka marrë në konsideratë këtë fakt. Personi me nr. 1 në listë është transferuar në IEVP Belsh në datën 08.04.2023, tre ditë pas përmbylljes së listës së zgjedhësve, prandaj nuk mund të regjistrohej në listën e zgjedhësve.

- (e) Komisioni i qendrës së votimit është i detyruar ligjërisht të lejojë votimin e personave që paraqiten me vendim gjykate. Moslejimi për votim do të formonte përjashtim nga e drejta e votimit. Përjashtimi nga e drejta e votimit formon shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor.
- (f) Ligjëshmëria e vendimeve gjyqësore, nga ana tjetër, nuk mund të vihet në diskutim nga organet e administratës publike që vihen në lëvizje për zbatimin e tyre (administrata zgjedhore në këtë rast), sikurse kundërshtimi i tyre nuk mund të bëhet në rrugën e ankimimit administrativ.

Në tërësi, votimi me vendim gjyqësor i 20 personave që ndodhen në kujdesin e IEVP Belsh është votim i ligjshëm dhe nuk përbën shkelje që cënon procesin zgjedhor, kurse për dy persona, për të cilët autorizimi i marrë nga gjykata mund të trajtohet si shkak pavlefshmërie, KAS-i çmon se nuk mund të shkohet tek deklarimi i pavlefshmerinë, sa kohë që rasti i tyre nuk plotëson kushtin e masës kritike që kërkon neni 160 i Kodit Zgjedhor.

- 23. Mungesa e pajisjes PEI të identifikimit elektronik dhe e kamerave për regjistrimin video në QV nr. 2556/01, pavarësisht nga vërtetësia e faktit, nuk ngrihen dot në nivelin e shkeljeve që cënojnë procesin. Në institucionet e vuajtjes së dënimit aksesi i personave nga jashtë është i kufizuar, rregullat e lëvizjes të rrepta dhe verifikimi i identitetit të zgjedhësve i sigurtë. Nga ana tjetër, rregullat e përdorimit të pajisjes PEI nuk e përjashtojnë, por e përmbajnë opsionin e kontrollit

manual të identitetit të votuesve si kur paisja PEI është në përdorim, ashtu dhe kur ajo është jashtë përdorimit. Në këtë QV është bërë kontrolli manual i identitetit të votuesve dhe kjo procedurë është e rregullt dhe e ligjshme.

24. I njejtë arsyetim vlen edhe për mungesën e kamerave për regjistrimin video në këtë QV. Kodi Zgjedhor nuk u ka konsideruar paisjen me kamera kusht për vlefshmërinë e votimit. Kamerat janë instrument shtese i logjistikës së procesit, të cilat janë shtuar për efektin deterrent që bartin dhe për provueshmërinë eventuale të shkeljeve. Por kamerat janë instrument dytësor. Ato nuk e zhbëjnë rolin që luajnë komisionerët dhe vëzhguesit si garantë të procesit dhe as vlerën që ka dokumentimi me shkrim i incidenteve në librin e protokollit të KQV-së. Pavlefshmëria në QV nr. 2556/01 nuk mund të kërkohet për shkak të mungesës së pajisjes PEI të identifikimit elektronik dhe të kamerave për regjistrimin video. Ajo mund të kërkohet për shkelje që mund të kenë ndodhur gjatë procesit të votimit. Kur nuk ka shkelje, nuk mund të ketë as pavlefshmëri.
25. Grupi i fundit i pretendimeve të ankuesit kishte lidhje me një grup shkeljesh, për të cilat ankuesi nuk paraqiti prova dhe nuk lidhi kërkime. Në këto rrethana ishte e pamundur për KAS-in që të thellonte hetimin në këto drejtime.
26. Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i mund të pranojë dhe reflektojë vetëm ndryshimet në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët për kryetar bashkie në këtë zonë, që kanë dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave të vlefshme dhe të pavlefshme dhe duhet të rrëzojë kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në IEVP Belsh, si të pa mbështetur në ligj dhe në prova.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21 pika 1 shkronja “b” dhe 143 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 76, datë 22.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë".
2. Ndryshimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023", sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 06.06.2023.
3. Rrëzimin e kërkesës për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit nr. 2565/01, IEVP Burgu Kosovë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 06.06.2023.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>	<b>(Pjesërisht kundër)</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>	<b>(Pjesërisht kundër)</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>	

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 76 të subjektit zgjedhor koalicioni Bashkë Fitojmë me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;* Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore, bashkia Belsh; Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë; Shpalljen fitues për kryetar të bashkisë Belsh, zotin Bedri Qypi, propozuar nga subjekti zgjedhor *“Bashkë Fitojmë”*”, ne anëtarët në pakicë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi pjesërisht kundër vendimit të shumicës së anëtarëve të KAS për rrëzimin e ankimit sa i përket përfshirjes në rezultatin zgjedhor të qendrës së votimit nr. 2565/1, IEVP Lushnjë.

2. Si fillim, gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë ankimore në KAS, u rinumëruan dhe rivlerësuan të gjitha fletët e votimit për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh, si ato të vlefshme ashtu edhe ato të pavlefshme. Në përfundim të kësaj procedure, me vendim të ndërmjetëm të KAS, u miratua Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh. Nga kjo tabelë, ndër të tjera ka rezultuar se numri i votave të vlefshme ka qenë 9079 dhe i atyre të pavlefshme 186. Votat e vlefshme janë ndarë mes dy kandidatëve në 4564 vota kandidati Arif Tafani dhe 4515 vota kandidati Bedri Qypi. **Diferenca mes dy kandidatëve është rritur në 49 vota (nga 40 vota që ka qenë në tabelën përmbledhëse objekt i këtij ankimi).**

3. Ne anëtarët në pakicë, ndahemi nga shumica e anëtarëve të KAS në lidhje me përfshirjen në Tabelën Përmbledhëse e Rezultateve për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh të qendrës së votimit 2565/1 që i përket zonës së veçantë të qendrës së votimit, institucionit të posaçëm IEVP Lushnjë.

4. Si fillim, do të bëjmë analizën ligjore në lidhje me krijimin e qendrave të votimit në institucionet e posaçme. Neni 2 pika 2 i K.Zgjedhor i përkufizon “institucionet e posaçme” si “burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë”. Neni 43 i K.Zgjedhor parashikon se “KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja”. Neni 62 pika 2 e K.Zgjedhor parashikon se “Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës”.

5. Nga provat e paraqitura gjatë shqyrtimit administrativ në KAS rezulton se KZAZ nr. 45, me vendimin e saj nr. 3, datë 25.03.2023 “Mbi ngritjen e KQV-së 2565/01”, ka vendosur “Ti propozojë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që KQV nr. 2565/1 të mos ngrihet në këtë institucion”. Anëtarët e KZAZ kanë arritur unanimisht në këtë vendimmarrje pasi kanë arsyetuar se “Mbështetur në verifikimin e të dënuarve në këtë institucion, konstatoi se nuk ka banorë të Bashkisë Belsh, si dhe historikisht nuk kanë votuar në zgjedhje vendore”. Në muajin mars 2023, IEVP Lushnjë i është drejtuar Gjendjes Civile Belsh dhe për dijeni Bashkisë Belsh, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën me lëndë “Dërgim dokumentacioni” duke i dërguar listat e personave që kanë të drejtë vote sipas tyre. Sipas listës bashkëlidhur, janë 45 persona. Në vijim të kësaj shkrese që është protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në datë 31.03.2023, nuk ka asnjë kthim përgjigje apo veprim nga gjendja civile për regjistrimin e këtyre personave me “vendbanim” në Bashkinë Belsh. Më tej, në datën 12.05.2023 (vetëm dy ditë përpara datës së zgjedhjeve), me anë të shkresës 1344 Prot. të Bashkisë Belsh, kjo e fundit i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që “Nisur nga situata që votuesit e Qendrës së Votimit nr. 2565.01 të IEVP Lushnjë (Burgu i Kosovës) nuk u regjistruan nga sistemi i Gjendjes Civile për shkak të vonesave, Bashkia Belsh ju kërkon që në bazë të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_.05.2023 të bëni regjistrimin e tyre. Bashkangjitur keni listën dhe 24 vendime të lëshuara nga

*kjo Gjykatë për secilin votues". Në vijim të kësaj shkrese, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 501, datë 12.05.2023 "Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 2565/01, KZAZ nr.45, bashkia Belsh, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", pasi ka vërejtur se "Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 45, Bashkia Belsh me shkresën nr. 5042 prot., datë 12.5.2023, "Për ngritjen e KQV-së së posaçme", i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr.2565/01 të IEVP Lushnjë (burgu i Kosovës). Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë administruar 24 vendime për 24 shtetas, të administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur dhe të dënuar, që ndodhen aktualisht në IEVP Lushnjë, të cilët kanë të drejtë vote por nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve, të QV nr. 2565/01. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr.45, Bashkia Belsh, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 2565/01, nga qendrat e tjera të votimit të KZAZ-së nr. 45, me procesverbale", ka vendosur ndër të tjera "Autorizimin e KZAZ-së nr. 45, Bashkia Belsh, që me vendim të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 2565/01."*

6. Nga krijimi i qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Lushnjë, vihet re që nuk është respektuar neni 43 i K.Zgjedhor, pasi pavarësisht se në vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është cituar se ka pasur një propozim të KZAZ, por në fakt nuk ka një propozim të KZAZ, por të vetë Bashkisë Rrogozhinë, propozim ky që është bërë vetëm 2 ditë para datës së zgjedhjeve, ndaj jemi në kushtet që nuk është respektuar procedura e parashikuar nga neni 43 i K.Zgjedhor për krijimin e kësaj qendre votimi të posaçme.

7. Neni 165 pika 1 e K.Zgjedhor parashikon se "**Kryetarët e bashkive si dhe këshillat e bashkive zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë"**. Nga kjo dispozitë kuptojmë se vendbanimi në territorin e bashkisë është kush *sine qua non* që një zgjedhës të ketë të drejtën e zgjedhjes për kryetarin e asaj bashkie, në rastin konkret, çdo shtetas shqiptar, me vendbanim në Belsh, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën 14 maj 2023, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike kishte të drejtë të zgjidhte kryetarin e bashkisë Belsh.

8. Gjatë shqyrtimit administrativ të kësaj kërkesë ankimore, subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe subjekti zgjedhor kandidati për kryetar bashkie që mbështetej nga ky koalicion, ngritën pretendime në lidhje me vendbanimin e zgjedhësve që ishin pjesë e listës së zgjedhësve të qendrës së votimit 2565/1 IEVP Lushnjë, pasi sipas tyre, pavarësisht përfshirjes në listë të 24 zgjedhësve, asnjë prej tyre nuk ishte ime vendbanim në territorin e bashkisë Belsh.

9. Në këto kushte, për ne anëtarët ne pakicë të KAS, është e domosdoshme që të analizojmë në mënyrë shteruese kuptimin e “vendbanimit”, për më tepër në kuptim të të drejtës së zgjedhjes në rastin e zgjedhjeve vendore. Si fillim do i referohemi K.Civil i cili në nenin 12 të tij, në paragrafët 1 dhe 3 parashikon se:

*“Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.*

...

*Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim”.*

Më tej, në neni 14 të tij, K.Civil parashikon se **“Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t’u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre”.**

Në lidhje me vendbanimin do i referohemi gjithashtu edhe ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” të ndryshuar, i cili në nenin 18 të tij rregullon edhe regjistrimin e vendbanimit në institucionet e vuajtjes së dënimit. Neni 18 i këtij ligji, ndër të tjera, parashikon se:

**“1. Për shtetasit që:**

...

**b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;**

...



**dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.**

**2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.**

**3. Kur përfundon qëndrimi i shtetasve në një nga institucionet e përcaktuara në këtë nen, institucioni përkatës njofton zyrën e gjendjes civile brenda juridiksionit të tij territorial, në lidhje me këtë fakt, brenda 5 ditëve. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet në Regjistrin Kombëtar, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile.**

**4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e njoftimit nga ana e institucioneve për kategoritë e shtetasve të përcaktuar në këtë nen”.**

**Në zbatim të pikës 4 të këtij neni, ka dalë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12.2009 “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/ njësi administrative dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve” i ndryshuar, i cili përcakton ndër të tjera afatet dhe mënyrën e kryerjes së veprimeve nga ana e institucioneve të vuajtjes së dënimit, por që në rastin e IEVP Belsh rezulton që as afatet dhe as mënyra nuk janë zbatuar në përputhje me ligjin apo VKM-në. Megjithatë, në zbatim të pikës 6 të kreut II të kësaj VKM, me urdhrin nr. 87, datë 1.2.2013 të Ministrit të Brendshëm është miratuar Rregullorja “Për përcaktimin e rregullave dhe veprimeve, që duhet të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, për ndryshimin e vendbanimit /adresës së shtetasve”. Në pikën 6 të kësaj rregulloreje parashikohet se **“6. Ndryshimi i vendbanimit/adresës për shtetasit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit, në institucionet mjekësore të kurimit afatgjatë dhe institucionet arsimore, kryhet pasi nëpunësi i zyrës së gjendjes civile merr dokumentacionin nga institucioni përkatës, sipas pikës 1 të kësaj rregulloreje”**. Më tej, në pikën 7 të po kësaj rregulloreje, në paragrafin e dytë të shkronjës “a” parashikohet se **“Pasi plotëson rubrikat e mësipërme, zgjedh llojin e vendbanimit: “vendqëndrimi i përkohshëm”, duke ndryshuar vetëm adresën e personit, e cila do të jetë, adresa e institucionit përkatës”**.**

Duke ju referuar bazës ligjore të sipërcituar, vihet re se ka kolizion mes normave sa i përket kuptimit të “vendbanimit” për personat që janë duke vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Megjithatë, për ta interpretuar në mënyrë teleologjike (qëllimore) kuptimin e vendbanimit në raport me të drejtën e zgjedhjes për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, do i referohemi edhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 40, datë 16.11.2007 në të cilin është arsyetuar ndër të tjera se “*Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve.*”

...

*Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit. **Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimi parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga poshtë lartë duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin.***

*Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. **Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.***

***Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqëndrimin”.***

Pavarësisht se kjo vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese ka interpretuar të drejtën e votës të personave që vuajnë dënimin në IEVP në kuptim të një dispozite në K.Zgjedhor që nuk është më në fuqi apo që ligji që është sot në fuqi sa i përket gjendjes civile nuk ka qenë në fuqi në atë kohë, parimi i përcaktimit të vendbanimit mbetet i njëjtë për atë kohë sa dispozitat përkatëse në K.Civil janë të njëjta si në vitin 2007.

Në lidhje me kolizionin mes normave, do i referohemi sërish jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese e cila në vendimin nr. 2, datë 03.02.2010 ka arsyetuar se ***“Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (lex superior derogat inferiori). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (lex specialis derogat generali) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.”***

Po ashtu, në lidhje me kolizionin mes normave, edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007 është arsyetuar se: ***“Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike të institucioneve të sipërpërmendura u jep atyre fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ata renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Mbështetur në këto konsiderime Gjykata Kushtetuese rithekson se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë***

**dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ata të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenet 6 dhe 81, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës.**

*Nga ana tjetër, kjo do të thotë se edhe ndryshimet që mund t’u bëhen këtyre ligjeve ose dispozitave të veçanta të tyre nuk mund të arrihen nëpërmjet një ligji të thjeshtë, por nëpërmjet një ligji që do të kërkonte sërish të paktën tri të pestat e deputetëve. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar”.*

**Për aq kohë sa Kodi Civil dhe Kodi Zgjedhor janë ligje organike që miratohen me jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit sipas nenit 81 pika 2 shkronjat “c” dhe “d” të Kushtetutës, ndërsa ligji “Për gjendjen civile” miratohet me shumicë të thjeshtë të votave nga Kuvendi sipas nenit 78 të Kushtetutës, atëherë sa i përket kuptimit të “vendbanimit” për personat e burgosur që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, do i referohemi K.Civil në zbatim të parimit *lex superior derogat inferiori*.**

10. Gjatë seancës së shqyrtimit administrativ në KAS, nga pala e interesuar, subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, u shtrua për diskutim çështja se nëse personat që po vuanin dënimin në IEVP Lushnjë, nuk do të mund të votonin në këtë qendër të posaçme votimi (pavarësisht vendbanimit të tyre), atëherë a nuk do të shndërrohej ky fakt në mohim të të drejtës së votës?! Që të japim një përgjigje në lidhje me këtë çështje, ajo që duhet të kuptojmë është nëse ka një lidhje të drejtpërdrejtë të burgosurve me komunitetin ose Bashkinë ku ndodhet IEVP përkatëse. K.Penal, alternativën e vetme të burgimit që është ndërthurje mes vuajtjes së dënimin me burg dhe jetës në komunitet, ka atë të gjysmëlirisë që parashikohet nga neni 58 i tij. Paragrafi i parë i këtij neni që parashikon se “Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri” e bën të qartë që kjo alternativë dënimi jepet vetëm ndaj personave që kanë

vendbanimin në të njëjtën bashki me vendin e vuajtjes së dënimit, pasi në rast të kundërt nuk do të bënte sens aplikimi i kësaj alternative të dënimit me burgim. Nga lista e personave që vuajnë dënimin në IEVP Lushnjë, nuk rezulton asnjë prej tyre që të jetë në kushtet e gjysmëlirisë, ndaj lidhja e atyre votuesve që nuk janë me vendbanim në Rrogozhinë me komunitetin e kësaj bashkie është inekzistente.

Sa i përket lidhjes së tyre me Bashkinë Belsh në kuptim të funksioneve të bashkisë në raport me ta, nëse i referohemi neneve 23 – 29 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nuk rezulton që asnjë funksion i bashkisë të prekë të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. **Në momentin që nga provat objekt shqyrtimi administrativ, rezulton se ndryshimi i qendrës së votimit duke ndryshuar vendbanimin me vendim gjykate është bërë me qëllimin e vetëm votimin në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, atëherë për ne anëtarët në pakicë, zbatimi i një të drejte kushtetuese siç është e drejta e votës në korniza krejt formaliste, e bën atë të pakuptimtë për shkak se mungon interesi real dhe legjitimiteti i zgjedhësit në zgjedhjen/votën e tij.**

Situata do të ishte krejtësisht ndryshe nëse personave që vuajnë një dënim me burgim ditën e zgjedhjeve, do t’i mundësohej votimi me postë ose me elektronikë në mënyrë që vota e tyre të përlllogaritej në bashkinë ku ata kanë vendbanimin dhe jo vendqëndrimin e përkohshëm për shkak të vuajtjes së një dënimi penal. Duke qenë se K.Zgjedhor nuk njih një mënyrë të tillë votimi, atëherë nuk mund të themi se po i kufizohet e drejta e votës atyre personave që vuajnë një dënim me burgim dhe IEVP ku ata vuajnë dënimin ndodhet jashtë bashkisë ku ata janë me vendbanim. Për më tepër K.Zgjedhor me “institucione të posaçme” nuk kupton vetëm burgjet dhe vendet e paraburgimit, por kupton dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë, ndërkohë që nuk ka asnjë qendër të tillë të posaçme që të jetë krijuar në spitale apo institucione të tjera shëndetësore, as për këto zgjedhje dhe as për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021 kur kishte një numër të konsiderueshëm personash që për shkak të pandemisë ishin në spitale për më shumë se tre ditë. GjEDNj, në çështjen *Mironescu k. Rumanisë* (Aplikimi 17504/18 § 50) është shprehur se “*Së fundmi, pa vënë në dyshim vlefshmërinë e kufizimit territorial si të tillë (shih paragrafin 37 më lart), fakti që në shtetin e paditur janë gjetur zgjidhje në mënyrë që jorezidentët dhe personeli ushtarak apo policor i vendosur jashtë vendit të mund të votojnë në një zonë zgjedhore të ndryshme nga ajo e vendbanimit (shih nenin 83 të Ligjit për Zgjedhjet*

*Legjislative, cituar në paragrafin 11 më lart), tregon se **kërkesa për vendbanim nuk ishte thelbësore në sistemin aktual zgjedhor**". Nëse e interpretojmë *a contrario* këtë vendim të GjEDNJ në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi administrativ, në rastin e Shqipërisë ende nuk ka një zgjidhje për ushtrimin e të drejtës së votës në një zonë zgjedhore të ndryshme nga ajo e vendbanimit (në mënyrë që vota të përlllogaritet në zonën zgjedhore ku ai ka vendbanimin), pra mundësi e vetme është votimi fizik në qendrën e votimit ku zgjedhësi ka vendbanimin, çka do të thotë se kërkesa për vendbanim është thelbësore në sistemin tonë aktual zgjedhor. Si përfundim, kufizimi i të drejtës së votës në raport me vendbanimin, aq më tepër në zgjedhje vendore, nuk mund të konsiderohet si kufizim i të drejtës së votës, parë kjo në raport me praktikën zgjedhore në vendin tonë, nenin 3 të Protokollit 1 të KEDNJ (e cila gjithashtu sipas jurisprudencës së GjEDNJ nuk i përfshin zgjedhjet vendore), por dhe me vetë funksionet e qeverisjes vendore.*

11. Në lidhje me konceptin e vendbanimit dhe vendqëndrimit, është për t'u theksuar që sado të kenë avancuar si koncepte që nga miratimi i dispozitave përkatëse në K.Civil, fakti që ligjvënësi nuk i ka ndryshuar këto dispozita, nuk mund të sjellë si pasojë cënimin e parimit të të drejtës për caktimin lirisht të vendbanimit (paragrafi dytë i nenit 12 të K.Civil). Jo më kot, ligjvënësi i ka kategorizuar si vendqëndrime vendet ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre (neni 14 i K.Civil). Nga këto dy koncepte del qartë që personi ka lirinë e plotë për të zgjedhur vendbanimin e tij, por jo vendqëndrimin pasi ky i fundit mund të ndryshojë në varësi të rrethanave shëndetësore apo edhe për shkak të një dënimi me burgim. Për rrjedhojë, e drejta për të zgjedhur lirisht vendbanimin që është një nga liritë dhe të drejtat vetjake të personit (neni 38 i Kushtetutës), përveçse parashikohet nga K.Civil, por është dhe një nga të drejtat kushtetuese të individit në Shqipëri. Ndaj ligjvënësi nuk mundet të kufizojë këtë të drejtë me një ligj me shumicë të thjeshtë siç është ligji në fuqi për gjendjen civile pavarësisht faktit që ai është miratuar më vonë në kohë.

12. Për sa kemi analizuar më sipër, ne anëtarët ne pakicë, kemi krijuar bindjen se dy janë elementet që çënojnë vendimin objekt shqyrtimi administrativ në KAS:

- I. **Krijimi i qendrës së votimit të posaçme 2565/1 IEVP Lushnjë në kundërshtim me nenin 43 të K.Zgjedhor; dhe**
- II. **Ndryshimi i “vendbanimit” për 24 zgjedhës nga vendbanimet e tyre te vendqëndrimi i tyre i përkohshëm në kundërshtim me nenet 12 dhe 14 të K.Civil, dispozita këto që garantojnë lirinë e zgjedhjes së vendbanimit.**

13. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se të gjithë elementët e arsyetuar më sipër, duhet të sillnin si pasojë mospërfshirjen e rezultatit të votimit të qendrës së votimit nr. 2565/1, IEVP Lushnjë dhe për rrjedhojë shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023 duke mos përfshirë në të rezultatit e qendrës së votimit nr. 2565/1, IEVP Lushnjë.

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**



**QARKU Elbasan**  
**KZAZ NR 45**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE  
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 2551/00	QV nr 2551/01	QV nr 2552/00	QV nr 2552/01	QV nr 2553/00	QV nr 2553/01	QV nr 2554/00	QV nr 2555/00	QV nr 2556/00	QV nr 2557/00	QV nr 2558/00	QV nr 2558/01	QV nr 2559/00	QV nr 2560/00	QV nr 2561/00	QV nr 2561/01	QV nr 2562/00
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	301	220	180	164	196	217	113	296	424	294	161	197	311	277	197	230	142
	gjithsej	149	111	92	82	97	114	54	159	224	149	83	106	160	135	99	125	81
3	Fletë votimi të papërdorura	331	404	353	372	355	328	239	684	524	650	379	341	579	509	383	388	435
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	1	0	0	0	1	0	0	1	0	1	7	0	0	0	3
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	301	220	180	164	196	217	113	296	424	295	161	196	311	277	197	230	142
6	Vota të pavlefshme	7	7	4	2	2	3	4	9	12	5	3	5	2	3	1	0	1
7	Vota të vlefshme	294	213	176	162	194	214	109	287	412	289	158	191	309	274	196	230	141
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 2551/00	QV nr 2551/01	QV nr 2552/00	QV nr 2552/01	QV nr 2553/00	QV nr 2553/01	QV nr 2554/00	QV nr 2555/00	QV nr 2556/00	QV nr 2557/00	QV nr 2558/00	QV nr 2558/01	QV nr 2559/00	QV nr 2560/00	QV nr 2561/00	QV nr 2561/01	QV nr 2562/00
1	Arif Faik Tafani	168	87	75	74	91	67	57	113	269	100	77	99	221	136	111	109	77
2	Bedri Skënder Qypi	126	126	101	88	103	147	52	174	143	189	81	92	88	138	85	121	64
	Gjithsej vota të vlefshme	<b>294</b>	<b>213</b>	<b>176</b>	<b>162</b>	<b>194</b>	<b>214</b>	<b>109</b>	<b>287</b>	<b>412</b>	<b>289</b>	<b>158</b>	<b>191</b>	<b>309</b>	<b>274</b>	<b>196</b>	<b>230</b>	<b>141</b>

Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 1

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

Model: KQZ-00-29 i miratuar me udhëzim të Komisionerit nr.2 datë 13.04.2023





**QARKU Elbasan**  
**KZAZ NR 45**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE

Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 2563/00	QV nr 2564/00	QV nr 2565/00	QV nr 2565/01	QV nr 2566/00	QV nr 2567/00	QV nr 2569/00	QV nr 2570/00	QV nr 2571/00	QV nr 2572/00	QV nr 2573/00	QV nr 2574/00	QV nr 2575/00	QV nr 2576/00	QV nr 2577/00	QV nr 2579/00	QV nr 2580/00
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	320	352	273	29	246	224	321	302	235	337	256	251	184	262	213	231	197
	gjithsej	165	187	128	0	128	113	157	128	126	176	139	124	92	139	103	112	111
	gra	635	615	578	6	473	224	681	567	374	607	308	453	184	262	473	301	458
3	Fletë votimi të papërdorura	0	7	1	3	0	9	0	1	0	1	0	1	0	0	1	0	3
4	Fletë votimi të dëmtuara	320	352	273	29	246	224	321	303	235	338	256	251	184	262	213	231	197
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	7	11	6	0	9	6	11	4	2	4	5	7	6	3	3	2	5
6	Vota të pavlefshme	313	341	267	29	237	218	310	298	233	334	251	244	178	259	210	229	192
7	Vota të vlefshme	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Fletë votimi të hedhura gabim																	

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 2563/00	QV nr 2564/00	QV nr 2565/00	QV nr 2565/01	QV nr 2566/00	QV nr 2567/00	QV nr 2569/00	QV nr 2570/00	QV nr 2571/00	QV nr 2572/00	QV nr 2573/00	QV nr 2574/00	QV nr 2575/00	QV nr 2576/00	QV nr 2577/00	QV nr 2579/00	QV nr 2580/00
1	Arif Faik Tafani	152	139	128	25	113	72	172	144	100	189	132	144	77	114	104	124	125
2	Bedri Skënder Qypi	161	202	139	4	124	146	138	154	133	145	119	100	101	145	106	105	67
	Gjithsej vota të vlefshme	<b>313</b>	<b>341</b>	<b>267</b>	<b>29</b>	<b>237</b>	<b>218</b>	<b>310</b>	<b>298</b>	<b>233</b>	<b>334</b>	<b>251</b>	<b>244</b>	<b>178</b>	<b>259</b>	<b>210</b>	<b>229</b>	<b>192</b>

Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja 2

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

Model: KQZ-00-29 i miratuar me udhëzim të Komisionerit nr.2 datë 13.04.2023



**QARKU Elbasan**  
**KZAZ NR 45**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE  
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Belsh



1	QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	QV nr 2582/00	QV nr 2583/00	QV nr 2584/00	QV nr 2585/00	QV nr 2586/00	QV nr 2587/00							Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
2	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	204	256	96	165	249	137							X X X	9260	NëntëmijëDyqindGjashtëdhjetë
	gjithsej	204	256	96	165	249	137							X X X	9260	NëntëmijëDyqindGjashtëdhjetë
	gra	98	126	41	84	124	71							X X X	4692	KatërmijëGjashtëqindNëntëdhjetëDy
3	Fletë votimi të papërdorura	410	542	222	165	459	401							X X X	16652	GjashtëmbëdhjetëmijëGjashtëqindPesëdhjetëDy
4	Fletë votimi të dëmtuara	0	0	1	2	0	0							X X X	44	DyzetëKatër
5	Fletë Votimi të gjetura në kuti	204	256	96	165	249	137							5	9267	NëntëmijëDyqindGjashtëdhjetëShtatë
6	Vota të pavlefshme	7	6	3	5	4	0							0	186	NjëqindTetëdhjetëGjashtë
7	Vota të vlefshme	197	250	93	160	245	137							5	9079	NëntëmijëShtatëdhjetëNëntë
8	Fletë votimi të hedhura gabim	0	0	0	0	0	0							X X X	2	Dy

SHPËRNDARJA E VOTAVE TË VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, atësia, mbiemri)	QV nr 2582/00	QV nr 2583/00	QV nr 2584/00	QV nr 2585/00	QV nr 2586/00	QV nr 2587/00							Fl. Vot. Gabim	Totali	Totali me fjalë
1	Arif Faik Tafani	110	88	58	90	166	66							1	4564	KatërmijëPesëqindGjashtëdhjetëKatër
2	Bedri Skënder Qypi	87	162	35	70	79	71							4	4515	KatërmijëPesëqindPesëmbëdhjetë
	Gjithsej vota të vlefshme	<b>197</b>	<b>250</b>	<b>93</b>	<b>160</b>	<b>245</b>	<b>137</b>							<b>5</b>	<b>9079</b>	NëntëmijëShtatëdhjetëNëntë

Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Zv/Kryetar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Anëtar  
(Emër, Mbiemër, Firmë)

Faqja e Fundit

ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023